

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	---	---

Nr: 02/2025	Nr: Protokolli: 02/2025
Për:	INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., Rr.Garibaldi, 10 000, Prishtin me adresë në Prishtine
Nga:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: Fatos Kuqi
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës -Refuzohet
Datë:	08.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **03.01.2025** nga Operatori Ekonomik: **INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., Rr.Garibaldi, 10 000, Prishtin me adresë në Prishtine** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja e ndërtesave administrative** me Numër të prokurimit: **624-24-11856-2-2-1** Numër i brendshëm **624-24-102-221** nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori **INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., Rr.Garibaldi, 10 000, Prishtin me adresë në Prishtine** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : **Mirëmbajtja e ndërtesave administrative** me Numër të prokurimit: **624-24-11856-2-2-1** Numër i brendshëm **624-24-102-221** kundër: (NJOFITIM VENDIMIT TE AK) të datës **27.12.2024** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

- I. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit të lartcekur.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., Rr.Garibaldi, 10 000, Prishtin me adresë në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : **Mirëmbajtja e ndërtesave administrative** me Numër të prokurimit: **624-24-11856-2-2-1** Numër i brendshëm: **624-24-102-221** Kundër (NJOFTIM VENDIMIT TE AK) të datës: **27.12.2024** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë **03.01.2024** sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,

Fillimisht AK sqaron se OE Ankues, përkundër që ka bërë kërkesë për qasje në dokumentet zyrtarë dhe qasja I është aprovuar nga ne si AK, I njëjti pra OE ankues nuk e ka shfrytëzuar qasjen e ofruar nga ana e jonë, andaj edhe pretendimet ankimore të cilat I ka cekur, nuk qëndrojnë, por për ne si AK është e pa kuptueshme dhe e pa kjashtë në qfare dokumente është bazuar kur ka vendosur pretendime ankimore për GOE të rekomanduar.

Megjithatë në vazhdim po japim arësytet e refuzimit të pretendimeve ankimore të OE ankues: Pretendimi I I-rë, I OE për ofertën e GOE të rekomanduar është se I njëjti nuk ka ofruar dëshmitë e kapacitetit financiar. **Kjo nuk qëndron** sepse GOE I rekomanduar ka ofertuar si Grup (GOE) dhe ka dorëzuar dëshmitë konform nenit 71 të LPP-së pika e 4, në të cilin është specifikuar:

Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit

Pra GOE të rekomanduar kanë ofruar dëshmitë për këtë kërkesë ne ofertën e tyre në dokumentin nr.2 të quajtur: 2. Qarkullimi përmes ATK-se.

Pra GOE të rekomanduar kanë plotësuar kërkesën për kapacitetin financiar në vlerë prej së paku 190,000.00 Euro (Vetëm deklarata tatimore e vitit 2021 të njërit anëtar është: 892,061.88).

Edhe pretendimi I dytë I OE ankues **nuk qëndron dhe ky pretendim** ka të bëjë me kapacitetin teknik profesional të GOE të rekomanduar ku është kërkuar: Kërkesa 9 - OE duhet të ket një ekspert për siguri të certifikuar nga MPMS me se paku 5 vite përvoj pune në siguri dhe shëndet në punë nga data e certifikimit. Dëshmia 9 - Kopja e Certifikatës nga MPMS.

Siq edhe e keni cekur ju si OE ankues, GOE të rekomanduar për këtë kërkesë ka ofruar një staf të certifikuar në Mars 2019, dhe në muajin Mars 2024 I ka plotësuar 5 vite përvojë siq janë kërkuar me dosje të tenderit. Pra ju e keni konfirmuar edhe vetë që kërkesa për këtë staf është plotësuar dhe si dëshmi siq mundë ta vereni është kërkuar: Dëshmia 9 - Kopja e Certifikatës nga MPMS dhe pretendimi juaj për dëshmi tjera nuk qëndron, sepse GOE të rekomanduar, **ka plotësuar këtë kërkesë të Dosjes së tenderit.**

Pretendimi tjetër I cili ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe profesional për të ofruar dëshmi për staf prej se paku 15 punëtorëve që do të angazhojë për shërbimet e pastrimit në të gjitha objektet, ndërsa 4 prej tyre duhet të jenë të certifikuar për mbrojtjen fillestare nga zjarri, **nuk qëndron** sepse GOE në ofertën e tyre kanë ofruar dëshminë në dokumentin 6.1 dhe 6.2 dhe dëshmitë janë siq janë kërkuar me dosje të tenderit. Pretendimi juaj se punëtorët e certifikuar për mbrojtje nga zjarri, janë certifikuar vetëm një ditë para datës së ofertimit, nuk është I arësyeshem sepse ky GOE kanë përmbushur kërkesën e Dosjes së tenderit dhe anëtar i tjetër I grupit ka ofruar dëshmi të certifikimit të punëtorëve edhe para datës së publikimit të tenderit edhe pse një kërkesë e tillë nuk është kërkesë e Dosjes së tenderit. Pra GOE I janë pranuar punëtorët e certifikuar sipas listave të dorëzuara dhe dëshmimeve (Certifikatave) e që numri I tyre është: 12, pra 6 nga njëri anëtar I grupit të certifikuar në vitin 2024, dhe 6 nga anëtar i tjetër I grupit të certifikuar në vitin 2019, ndërsa kërkesa ishte vetëm për 4 punëtor të certifikuar. Edhe pretendimi tjetër (pika 4) ku OE ankues ka pretenduar se nuk është dorëzuar një Deklaratë se do të paguajë pagën bazë dhe të respektojë Aneksin 1 dhe Ligjin e Punës Nr.03 L-212. Poashtu, deklarata duhet ti bashkangjitet Analiza Financiare me të gjitha llogaritjet, **nuk qëndron** sepse në ofertën e GOE të rekomanduar në dokumentin e quajtur: 9. Analiza financiare dhe deklarata në faqen nr.4 është dorëzuar deklarata siq është kërkuar me dosje të tenderit.

Po ashtu GOE të rekomanduar ka ofruar analizën financiare sipas pikave të kërkuara në dosje të tenderit ku janë përfshirë të gjitha kërkesat si për pagën bazë konform legjislacionit, për kontributet, vlera e materialit, vlera e uniformave, pagat e përgjegjësve dhe të menaxherit, pagat shtesë për ndrrimet e natës, ditëve të rregullta dhe vikendit, zëvendësimet e punëtorëve për pushimet vjetore, pagesat shtesë të ndrrimeve gjatë ditëve të vikendit, pagesa shtesë për festat zyrtare llogaritja e TVSH-së. Pras siq mundë ta shihni në analizën financiare GOE ka llogaritur të gjitha pikat që janë kërkuar me dosje të tenderit.

Edhe pika 4.1 apo pretendimi I fundit I juaji si OE ankues, është pse janë llogaritur pagat për menaxherin dhe mbikqyresin kur një gje e tillë nuk është specifikuar në DT, **nuk qëndron** sepse siq mundë ta shikoni të kërkesa dhe dëshmia e 7-të e dosjes së tenderit është kërkuar që në analizë financiare të përfshihet edhe: **pagat e përgjegjësve dhe të menaxherit**, të cilën GOE të rekomanduar e ka llogaritur në analizë financiare.

Për pretendimet tjera në pikat 4.2 deri në 4.4 ju konfirmojmë se të njëjtat **nuk qëndrojnë** siq e cekem edhe më sipër sepse GOE të rekomanduar ka ofruar analizë në detale ku janë përfshirë të gjitha kërkesat ligjore, si për pagën bazë konform legjislacionit në fuqi, për kontributet, vlera e materialit, vlera e uniformave, pagat e përgjegjësve dhe të menaxherit, pagat shtesë për ndrrimet e natës, ditëve të rregullta dhe vikendit, zëvendësimet e punëtorëve për pushimet vjetore, pagesat shtesë të ndrrimeve gjatë ditëve të vikendit, pagesa shtesë për festat zyrtare llogaritja e TVSH-së. Pras siq mundë ta shihni në analizën financiare GOE ka llogaritur të gjitha pikat që janë kërkuar me dosje të tenderit.

Pra anëtar i tjetër nga pretendimet tuaja nuk qëndron dhe GOE të rekomanduar është I përgjegjshëm dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Siq edhe e cekëm më sipër, për ne si AK është shqetësuese fakti I qasjes në dokumente publike, sepse kemi pranuar dy kërkesa për qasje në dokumente zyrtare për këtë procedurë, të dy kërkesat janë aprovuar nga ne si AK dhe vetëm një OE ka pranuar qasjen për ofertën e GOE të rekomanduar, por ky OE nuk është ankuar në këtë procedurë, ndërsa ju si OE ankues nuk keni pasur qasje në ofertën e GOE të rekomanduar. Ndërsa i referohemi disa dëshmime të

GOE të rekomanduar edhe pse ofertën e këtij GEO nuk e keni pranuar nga ne sepse nuk keni marr pjesë në qasje. Ju lutemi që të keni parasysh konsekuencat ligjore për këtë qështje.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

